



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Gjirokastrë, më 02/11/2020

Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus + me Universitetin Aristotle Selanik Greqi

Në kuadër të Programit Erasmus +, Universiteti Aristotle Selanik Greqi ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:

3 pozicione për staf akademik të cilët do të angazhohen në mësimdhënie për 7 ditë në Universitetin Aristotle Selanik Greqi specifikisht **Mars – Qershor 2021**

2 pozicione për staf akademik të cilët do të angazhohen në trajnim për 7 ditë në Universitetin Aristotle Selanik Greqi specifikisht **Mars – Qershor 2021**

Planifikimi i aktivitetit mësimor/mësimdhënies do të zhvillohet në vitin akademik **2020-2021 semestri i dytë** dhe gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht në nivelin B2. Sipas të dhënave nga Universiteti Aristotle Selanik Greqi.

Aplikimet janë të hapura për **FE, FESHSH dhe FSHN**

Nëse jeni të interesuar lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe, brenda dt. **15.11.2020**:

- një letër interesi e cila cilëson fushën tuaj studimore e që përshkruan ciklin e leksioneve që mendoni të zhvilloni në Universitetin Aristotle Selanik Greqi.
Letra të dorëzohet në shqip dhe në anglisht,
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht,
- një provë/çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose greke të nivelit B2

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision Ad Hoc i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës në Universitetin Aristotle Selanik Greqi ë për vlerësimin përfundimtar të aplikatëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR